

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 46/2018 “PËR KONTROLLIN SHTETËROR TË TRANSFERIMEVE NDËRKOMBËTARE TË MALLRAVE USHTARAKE DHE TË ARTIKUJVE E TEKNOLOGJIVE ME PËRDORIM TË DYFISHTË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë” ka si qëllim përmirësimin dhe qartësimin e parashikimeve ligjore lidhur me kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe atyre me përdorim të dyfishtë. Synohet të përfshihen parashikimet e nevojshme ligjore mbi kontrollin shtetëror të këtyre mallrave në kuadër të nevojave operationale të vendeve të NATO-s dhe angazhimeve të këtyre vendeve ose Aleancës në luftën kundër terrorizmit apo ndihmës së aleatëve. Gjithashtu, synohet të reflektohen një sërë ndryshimesh të konstatuara si të nevojshme në kuadër të Reformës së Derregullimit që lidhen veçanërisht me përmirësimin e kuadrit ligjor në funksion të ofrimit të shërbimeve në mënyrë më të shpejtë dhe efikase për marrësin e tyre.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, për Ministrinë e Mbrojtjes, për vitin 2024.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji nr. 46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë” rregullon transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara nëpërmjet sistemit të licencimit dhe autorizimit.

Gjatë viteve të fundit si rezultat i kërcënimeve të sigurisë në nivel global është kërkuar kontributi i Republikës së Shqipërisë nga vendet anëtare të NATO-s, në kuadër të luftës kundër terrorizmit ose në mbështetje të aleatëve.

Ky projektligj synon të përjashtojë nga fusha e zbatimit të këtij ligji këto raste, pasi ato do të rregullohen sipas udhëzimeve të kërkesës së vendeve të NATO-s. Në këto raste nuk mund të aplikohet sistemi i kontrollit dhe zbatimi i detyrimeve që vijnë nga ligji nr. 46/2018.

Me miratimin e këtij projektligji, Republika e Shqipërisë do të mund të kontribuojë në angazhimet ndërkombëtare në mënyrë më efikase.

Ndryshimet e propozuara janë konsultuar me DASH dhe ekspertët e tjerë, duke siguruar rekomandime mbi mënyrën e implementimit dhe zbatimit të këtij ligji.

Janë zhvilluar gjithashtu takime pranë Zyrës EXBS (*Export Control and Related Border Security Programme*), **Departamenti Amerikan i Shtetit**, me qëllim konsultimin me ekspertët USA mbi ndryshimet e ligjit nr. 46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë.

Gjatë analizës së kryer nga ekspertët janë dhënë rekomandime mbi mënyrën e implementimit dhe zbatimit të këtyre amendimeve.

Rekomandimi kryesor lidhet me përcaktimin vetëm të transferimeve ndërmjet qeverive si rast për përjashtimin nga detyrimi i licencimit nën këtë kontekst. **Vendimi për transferimin e mallrave të kontrolluara merret me vendim të qeverisë (pavarësisht nëse janë vende anëtare të NATO-s ose “për raste të veçanta të nevojave operationale të këtyre vendeve”).**

Rekomandimet e tjera përfshijnë situata procedurale që mund të rregullohen në vendimet e Këshillit të Ministrave që do të miratohen sipas rasteve specifike që do të hasen (përjashtimet doganore, licencimet, siguria kombëtare, interesat politike, traktatet etj.).

Propozimet e tjera për ndryshimin e ligjit nr. 46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, lidhen me zgjidhjen e problematikave apo përmirësimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve që AKSHE-ja ofron në kuadër të zbatimit të kompetencave të veta. Evidentimi i nevojës për ndryshim dhe propozimet për ndryshime janë bërë në kuadër të Reformes së Derregullimit dhe Riinxhinierimit të Shërbimeve dhe sipas diskutimeve me Ministrinë e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit dhe Ministrinë e Drejtësisë janë bërë ndryshimet në nenet të cilat kanë paqartësi juridike për subjektet.

Të gjitha dispozitat ku parashikohen kushte shtesë për ofrimin e shërbimit, por pa përcaktuar qartësisht dhe specifikisht kushtet për subjektet aplikuese janë shfuqizuar.

Është ndërhyrë gjithashtu në dispozitat të cilat rregullojnë të drejtën e ankimimit, duke unifikuar përcaktimin e kushteve të ushtrimit të kësaj të drejte, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Është ndërhyrë në dispozitat e ligjit për të ngarkuar Këshillin e Ministrave, në zbatim të këtij ligji, të përcaktojë kushtet, dokumentacionin, formatet, modelet e licencave, certifikatave etj.

Aktualisht të gjitha këto aspekte vendosen nga AKSHE-ja që është njëkohësisht edhe organi publik zbatues.

Ndryshimi është bërë dhe në kuadër të disa konsultimeve të zhvilluara me Ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit. Ky ndryshim është bërë për të zgjidhur disa problematika të cilat janë ngritur nga shoqëritë tregtare te Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit. Gjithashtu, ky ndryshim vjen si rrjedhojë edhe e rekomandimeve të fundit të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në të cilën është shprehur qartë nevoja për të ndryshuar këto dispozita, me qëllim ndarjen më të qartë të kompetencave sipas hierarkisë.

Më tej shtojmë së ndryshimet e bëra në projektligjit bazohen gjithashtu dhe mbi pikën 3, të nenit 2 dhe të pikës 3, të nenit 3, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Në këto pika është përcaktuar qartë se administrata shtetërore funksionon në mënyrë hierarkike, ku ndër të tjera një nga parimet kryesore është ai i llogaridhënies midis institucioneve në mënyrë hierarkike.

Në pikën 1, të nenit 6 të këtij ligji, është përcaktuar qartësisht se Këshilli i Ministrave është institucioni i cili zhvillon dhe e zbaton politikën e kontrollit për transferimin ndërkombëtar. Për këtë arsye ndryshimet e bëra përfshijnë dhënien e disa kompetencave Këshillit të Ministrave, pasi ky institucion ka si kompetencë zhvillimin e politikës shtetërore, ndërsa AKSHE-ja është një institucion varësie i Ministrisë së Mbrojtjes, i cili ngarkohet në zbatimin e politikave të ndërmarra nga Këshilli i Ministrave.

AKSHE-ja është e njëjta strukturë dhe i njëjti nivel vendimmarrje për licencimin (aplikimin e kritereve dhe verifikimin e dokumentacionit), kontrollin mbi mënyrën e përdorimit të licencës, inspektimin, raportimin e deri në vendosjen e sanksioneve në rastet kur aplikohen të tilla.

Ky ndryshim vlerësohet i nevojshëm për të siguruar kryerjen e funksioneve administrative në përputhje me parimin e unitetit dhe hierarkisë; qartësisht në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, eficiencës dhe efektivitetit (neni 2, i ligjit 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”);

Janë bërë ndryshime duke krijuar hapësirën ligjore për kryerjen e proceseve të regjistrimit, aplikimi dhe raportimit në mënyrë elektronike, si dhe gjithashtu janë bërë ndryshimet përkatëse që i paraprijnë procesit për ofrimin online të shërbimit dhe të lëshimit të licencës/autorizimit/certifikatës.

Ky draft projektligj është përgatitur në bashkëpunim me aleatët strategjikë të Republikës së Shqipërisë, konsultimeve me Ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, si dhe duke u bazuar në rekomandimet e lëna nga KLSH-ja.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje të plotë me rendin juridik të brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon të përfaqëzojë *acquis communautaire*

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është i përbërë nga 18 nene.

Në nenin 1 përcaktohen ndryshimet në nenin 3, ku pas germës “ç”, shtohet germa “d”, me përmbajtje, si vijon:

“d) transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, të cilat kryhen sipas udhëzimeve të vendeve anëtare të NATO-s, për rastet e veçanta të nevojave operacionale të këtyre vendeve.”

Kjo dispozitë do të bëjë të mundur përjashtimin e zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, me qëllim dhënien e asistencës në kuadër të nevojave operacionale të vendeve të NATO-s.

Në nenin 2 përcaktohet ndryshimi në paragrafin 1, të pikës 1, të nenit 9, i cili riformulohet, me përmbajtje, si vijon:

“1. Në Ministrinë e Mbrojtjes funksionon Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), e cila është struktura shtetërore përgjegjëse për zbatimin e politikës së kontrollit për transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake, të artikujve dhe të teknologjive me përdorim të dyfishtë.”

Riformulimi i nenit 2 ka për qëllim përcaktimin e fushës së kompetencës së Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, si institucion që zbaton politikën e qeverisë e cila përcaktohet në nenin 6, të ligjit 46/2018, për kontrollin e transferimeve ndërkombëtare.

Fjala e shtuar zbaton, ecën në vijë me hierarkinë e institucioneve, pasi AKSHE-ja është institucion ligjzbatues.

Në nenin 3 përcaktohet ndryshimi në paragrafin 1, të pikës 1, të nenit 10, i cili riformulohet, me përmbajtje si vijon:

“1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, me kontributet e ministrive dhe të organeve të tjera të interesuara, harton dhe propozon pranë ministrit të Mbrojtjes listën e mallrave, objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare.

Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit të Mbrojtjes miraton listën e mallrave ushtarake, të artikujve e të teknologjive me përdorim të dyfishtë, në përputhje me listat përkatëse të Bashkimit Evropian.”

Kjo dispozitë është ndryshuar për efekt të teknikës legjislative, me qëllim përcaktimin e procedurës propozuese deri në miratimin nga Këshilli i Ministrave.

Procedura deri në propozimin për miratim në Këshillin e Ministrave kalon nëpërmjet ministrit të Mbrojtjes, pasi ky i fundit ka kompetencën e vetme për t’iu drejtuar Këshillit të Ministrave.

Në nenin 4 përcaktohen shtesat dhe ndryshimet në germën “b”, të nenit 13, e cila riformulohet, si dhe shtohet germa “b.1”, me përmbajtje si vijojnë:

“b) *Subjekti aplikues është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, sipas dispozitave të ligjit penal në fuqi mbi tregtinë/prodhimin e mallrave ushtarake dhe armëve të shkatërrimit në masë, apo sipas dispozitave të tjera ligjore, që lidhen me rendin kushtetues dhe sigurinë kombëtare.*”;

“b.1) Subjekti aplikues është në procedim penal apo është dënua nga një gjykatë e huaj me vendim të formës së prerë për shkeljen e legjislacionit të huaj për kontrollin e transferimeve ndërkombëtare.”

Germa “b”, e nenit 13 ekzistues është riformuluar, si dhe është shtuar germa “b.1”, me qëllim qartësinë juridike, pasi kishte përfshirë në të njëjtën pikë të dyja rastet, rastet e refuzimit kur subjekti kishte kryer shkelje të legjislacionit kombëtar, si dhe ndërkombëtar dhe renditja e tyre është ndryshuar si më sipër.

Në nenin 5 përcaktohen ndryshimet në paragrafin 2, të pikës 2, të pikës 3, si dhe të germës “dh”, të pikës 5, të nenit 14, i cili riformulohet, si vijon:

Paragrafi i dytë, i pikës 2, të nenit 14 riformulohet, si vijon:

“Përcaktimi i formatit të regjistrimit, si dhe të dhënat e subjekteve të cilat duhet të regjistrohen bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Ky paragraf riformulohet si rezultat i diskutimeve me Ministrinë e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.

Kompetencat për miratimin e formatit të regjistrimit dhe përcaktimin e të dhënave që vlerësohen të nevojshme për t’u regjistruar i jepet Këshillit të Ministrave, duke qenë se Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve është autoriteti zbatues për mbajtjen e regjistrimit, si dhe për regjistrimin e të dhënave të subjekteve.

Në pikën 3, të nenit 14 togfjalëshi “miraton vendimet” zëvendësohet me fjalën “vendos”.

Ky ndryshim bëhet me qëllim përcaktimin më të saktë të procedurës së vendimmarrjes nga ana e AKSHE-së, pasi ky institucion ka kompetenca vendimmarrjeje mbi vendimet e mara po prej saj.

Në germa “dh”, të pikës 5, të nenit 14 togfjalëshi “arsye të tjera për cenimin e sigurisë kombëtare” zëvendësohet me togfjalëshin “dyshime të arsyeshme që cenojnë sigurinë kombëtare”.

Ky togfjalësh ndryshohet me qëllim përcaktimin më të saktë të arsyeve që sjellin pasoja që rëndojnë mbi subjektet, duke shmangur nevojën për të interpretuar togfjalëshin “arsye të tjera”, e cila lë vend për interpretime të mëtejshme.

Në nenin 6 përcaktohet se paragrafi i dytë, i pikës 4, të nenit 17, shfuqizohet.

Në nenin 7 përcaktohet se paragrafi i tretë, i pikës 1, si dhe fjalia e dytë, e pikës 2, të nenit 21, shfuqizohen.

Këta paragrafë shfuqizohen me qëllim qartësinë juridike të operatorëve ekonomikë, të cilët marrin licenca të transferimit ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara, duke mos vendosur kushte shtesë të papërcaktuara më parë në akte ligjore dhe nënligjore.

Në nenin 8 përcaktohet ndryshimi në pikën 3, të nenit 26, e cila riformulohet me përmbajtje, si vijon:

“3. Llojet e licencave/certifikatave dhe autorizimeve, dokumentacioni i aplikimit, formatet e kërkesave të aplikimeve, si dhe formatet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Kjo pikë riformulohet si rezultat i diskutimeve me Ministrinë e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.

Tagri për miratimin e dokumentacionit të aplikimit për licencat, certifikatat dhe autorizimet është i Këshillit të Ministrave, duke qenë se Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve nuk mund ta ketë këtë tagër, pasi është institucioni i cili po vetë i kontrollon këto dokumente.

Kompetenca për përcaktimin dhe miratimin e dokumentacionit të nevojshëm për t’u paraqitur pranë AKSHE-së, sikurse edhe llojet dhe formatet e këtyre të fundit i jepet Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit. AKSHE-ja është organi administrativ që kryen këto procese dhe ka të drejtën dhe përgjegjësinë e vendimmarrjes.

Përcaktohet Këshilli i Ministrave për të miratuar modelet standarde të dokumentacionit për licencat/autorizimet dhe certifikatat, formatet e kërkesave të aplikimit për këto dokumente, kriteret për aplikim për mallrat ushtarake dhe artikujt e teknologjitë me përdorim të dyfishtë. Aktualisht të gjitha sa u përmendën përcaktohen më urdhër të kryetarit të AKSHE-së. Paralelisht, është e njëjta strukturë dhe i njëjti nivel vendimmarrje edhe për licencimin (aplikimin e kriterëve dhe verifikimin e dokumentacionit), kontrollin mbi mënyrën e përdorimit të licencës, inspektimin, raportimin e deri në vendosjen e sanksioneve në rastet kur aplikohen të tilla.

Ky ndryshim vlerësohet i nevojshëm për të siguruar kryerjen e funksioneve administrative në përputhje me parimin e unitetit dhe hierarkisë; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, eficiencës dhe efektivitetit (neni 2, i ligjit 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”);

Në nenin 9 përcaktohet ndryshimi në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 29, e cila riformulohet me përmbajtje, si vijon:

“ç) Dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi është i paplotë dhe dokumentacioni shtesë i tejkalon afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 27.”

Kjo dispozitë është ndryshuar për të qartësuar rastet e refuzimit të licencimit.

Germa “ç” në ligjin aktual shprehet mbi “arsyet e tjera” të cilat sikurse dhe në dispozita të sipërcituara janë zëvendësuar me qëllim qartësinë juridike.

Në nenin 10 përcaktohet ndryshimi në pikën 2, të nenit 30, togfjalëshi “mund të miratojë një vendim” zëvendësohet me fjalën “vendos”.

Ky ndryshim bëhet me qëllim përcaktimin më të saktë të procedurës së vendimmarrjes nga ana e AKSHE-së, pasi ky institucion ka kompetenca vendimmarrjeje.

Ndryshimi është bërë pasi AKSHE-ja vendos mbi vendimet të cilat merren vetë nga ky institucion dhe jo duke miratuar vendime të marra nga institucionet e tjera.

Në nenin 11 përcaktohet ndryshimi në paragrafin e dytë, të pikës 2, të nenit 34, e cila riformulohet me përmbajtje, si vijon:

“Procedurat dhe kërkesat për marrjen e autorizimit do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Ndryshimi është bërë për të njëjtat arsye të argumentuara në nenet 5 dhe 8 të këtij relacioni shpjegues.

Në nenin 12 përcaktohen ndryshimet në germën “d” dhe në germën “e”, të pikës 3, të nenit 37.

Në germën “d”, të pikës 3, të nenit 37, hiqet togfjalëshi “incizimet audio-video”.

Ky ndryshim bëhet me qëllim uljen e barrës administrative dhe detyrimeve të subjekteve për të mbajtur të dhëna.

Germa “e”, e pikës 3, të nenit 37, shfuqizohet.

Kjo germë shfuqizohet, pasi nuk ka të përcaktuar në mënyrë të qartë dokumentacionin që mund të kërkohet.

Në nenin 13, pika 2, e nenit 38 riformulohet me përmbajtje, si vijon:

“2. Formatet e raportimit, si dhe afatet e koha e paraqitjes së raporteve do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Kjo pikë riformulohet si rezultat i konsultimeve me Ministrinë e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.

Tagri për përcaktimin e formateve të raportimit, si dhe afatet dhe koha e paraqitjes së raporteve është i Këshillit të Ministrave, duke qenë se Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksperteve nuk mund ta ketë këtë tagër, pasi është institucioni i cili i kontrollon këto dokumente dhe në këtë mënyrë është bërë për të shmangur konfliktin e interesit, që mund të lindë në të ardhmen.

Në nenin 14 përcaktohen ndryshimet në pikën 2, të nenit 42, e cila riformulohet si vijon:

“2. Subjekteve të pikës 1, përsëritëse të mbi dy herë të shkeljeve të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të këtij neni, përveç gjobës, u caktohet si masë shtesë që ndalimi i kryerjes së transferimit ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara.”

Kjo dispozitë është ndryshuar për të përcaktuar më qartë se masa shtesë që mund të vendoset është ajo e ndalimit të kryerjes së transferimit ndërkombëtar të mallrave ushtarake në rastet kur subjektet janë përsëritëse të mbi dy herë të shkeljeve të përcaktuara në germat “a” dhe “b”.

Në nenin 15 përcaktohen ndryshimet në pikën 4 dhe në pikën 5, të nenit 44.

Në pikën 4, të nenit 44, togfjalëshi “në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin” zëvendësohet me togfjalëshin “në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative”.

Në pikën 5, të nenit 44, hiqet togfjalëshi në fund të fjalisë “në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin për inspektimin”.

Këto pika janë ndryshuar për të unifikuar të dyja situatat e ankimit në të cilat aplikohen dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 16 shtohet, si vijon:

“Të gjitha procedurat e kryera sipas nevojave dhe/ose udhëzimeve të vendeve ose agjencive të NATO-s, për transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, me qëllim të dhënies së asistencës shtetërore ushtarake konsiderohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji.”

Kjo dispozitë do të bëjë të mundur rregullimin e procedurave të nisura dhe të kryera për transferimet ndërkombëtare në kuadër të nevojave operationale dhe asistencës shtetërore, ku ka kontribuar Republika e Shqipërisë.

Republika e Shqipërisë, me vendim të Këshillit të Ministrave, ka kontribuar në nevojat e vendeve të NATO-s për luftën kundër terrorizmit, si dhe në nevojat e aleatëve në konfliktin në Ukrainë.

Në nenin 17 përcaktohet shtimi i pikës 2, në nenin 47, si vijon:

“2. Detyrimet e subjekteve, sipas germave “d”, “dh”, të pikës 1, të nenit 38 dhe germës “k”, të nenit 41, zbatohen vetëm për rastet e licencave që lëshohen të printuara fizikisht.”

Në kuadër të riinxhinierimit të proceseve parashikohet që në të ardhmen do të bëhet e mundur që licencat do të nënshkruhen me vulë elektronike dhe do të lëshohen vetëm në mënyrë elektronike, dhe për këtë qëllim bëhet shtimi. Kur të jetë teknikisht e mundur që këto licenca do të lëshohen në mënyrë elektronike kjo dispozitë automatikisht bëhet e pazbatueshme.

Në nenin 18 përcaktohet hyrja në fuqi e këtij ligji.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Me zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Mbrojtjes dhe Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes.

Ky projektligj i është dërguar për mendim Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ministrinë të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Financave janë shprehur dakord pa komente.

Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit është shprehur dakord me sugjerimin se projektligji duhet të shoqërohet me projektvendimin propozues, sugjerim ky i cili është reflektuar.

Ministria e Drejtësisë është shprehur, si vijon:

1. Ndryshimi i pikës 1 të nenit 9, lë të paqartë statusin e AKSHE pasi paragrafi i dytë i pikës 1, që përcakton se Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksperteve është institucion qendror, me statusin e personit juridik, publik, në varësi të ministrit të Mbrojtjes, me seli në Tiranë, shfuqizohet. Në këto kushte, si dhe në mungesë të argumentimit të këtij ndryshimi në relacionin shpjegues nuk mund të përcaktohet nëse AKSHE do të vijojë të ketë të njëjtin status apo do të jetë pjesë e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Mbrojtjes.

- Sugjerimi është pranuar pjesërisht, pasi riformulimi i nenit 9 është vetëm për paragrafin e parë, të pikës 1, të nenit 9. Paragrafi i dytë i pikës 1, të nenit 9 mbetet i pandryshuar. Sugjerimi juaj është reflektuar dhe riformulimi është bërë vetëm për paragrafin e parë të pikës 1, të nenit 9.

2. Zëvendësimi i fjalës “harton” me fjalën “propozon” në pikën 1, të nenit 10, duhet të rishikohet. AKSHE nuk e ka të drejtën e propozimit të akteve pranë Këshillit të Ministrave, pasi këtë kompetencë e ka Ministri i Mbrojtjes. AKSHE mund të hartojë listën e mallrave dhe t’ia propozojë Ministrit të Mbrojtjes dhe më pas, ky i fundit ndërmerr iniciativën për t’i propozuar Këshillit të Ministrave miratimin e listës.

- Sugjerimi është pranuar dhe është reflektuar në përmbajtjen e projektligjit.

3. Të rishikohen në tërësi ndryshimet që kryhet në nenin 13 të ligjit. Shkronja “b” që ndryshohet në nenin 13, duhet të rishikohet pasi subjekti aplikues dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, sipas përcaktimeve të legjislacionit penal në fuqi dhe jo sipas përcaktimeve të këtij ligji apo sipas dispozitave të tjera ligjore. Ky ligj nuk ka dhe nuk mund të parashikojë vepra penale, por shkëlja e dispozitave ligjore sjell si pasojë lindjen e përgjegjësisë penale. Ndërkohë edhe ndryshimi/shtimi i shkronjës “c” duhet të rishikohet. Fillimisht sillet në vëmendje se në nenin 13 në fuqi ka tashmë një shkronjë “c” dhe si pasojë nuk mund të shtohet e njëjta shkronjë. Nga ana tjetër, duke prezumuar se qëllimi në këtë rast është ndryshimi i kësaj shkronje, sillet në vëmendje se ky ndërhyrja nuk sjell ndonjë ndryshim në përmbajtjen e nenit, pasi parashikimi i shkronjës “b” në fuqi është ndarë në dy shkronja të veçanta “b” dhe “c”, sipas variantit të projektligjit. Ndryshimi i vetëm që sjellin këto dispozita është heqja e kushtit që subjekti aplikues të mos ketë shkelur embargot apo sanksionet ndërkombëtare, i cili nuk është argumentuar në relacionin shpjegues. Si rrjedhim, nëse do të hiqet ky kriter, në relacionin shpjegues duhet të jepen arsye të qarta mbi problematikat e deritanishme dhe përparësitë që sjell heqja e këtij kushti dhe më pas të parashikohet shfuqizimi i shkronjës “c”.

- Sugjerimi është pranuar dhe është reflektuar në përmbajtjen e projektligjit.

Germa “b”, e nenit 13 do të ndahet në dy nënpika të veçanta (b.1;b.2), për shkak të qartësisë juridike.

Nënpika b.1 do të rregullojë rastin kur subjekti është dënuar me vendim të formës së prerë sipas parashikimeve të legjislacionit kombëtar.

Nënpika b.2 do të rregullojë rastet kur subjekti është në fazë procedimi penal apo është dënuar me vendim të formës së prerë sipas parashikimeve të legjislacionit ndërkombëtar.

Për sa i përket germës “c”, të nenit 13 ajo mbetet e pandryshuar.

4. Sa i përket nenit 5 të projektligjit, si edhe argumenteve të paraqitura në relacionin bashkëlidhur tij, nuk është e qartë arsyeja pse kompetencat e Kryetarit të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, i kalojnë Këshillit të Ministrave. Përderisa ligji në fuqi dhe projektligji parashikon mbajtjen e një regjistri të thjeshtë dhe jo bazë të dhënash shtetërore, ndryshimi i kësaj pike është i panevojshëm dhe ngarkon Këshillin e Ministrave me detyrimin për të miratuar formatin e një regjistri të thjeshtë, të cilin mund ta miratojë edhe ministri i Mbrojtjes apo Kryetari i AKSHE.

- Sugjerimi nuk është pranuar, pasi ndryshimi i bërë në nenin 5 të projektligjit ka ardhur si rezultat i disa konsultimeve të zhvilluara me Ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit. Ky ndryshim është bërë për të zgjidhur disa problematika të cilat janë ngritur nga shoqëritë tregtare të Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit. Gjithashtu ky ndryshim vjen si rrjedhojë edhe e rekomandimeve të fundit të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, në të cilat është shprehur qartë nevoja për të ndryshuar këtë dispozitë, me qëllim ndarjen e kompetencave sipas hierarkisë.

Më tej shtojmë së ndryshimi i bërë në nenin 5 të projektligjit bazohet gjithashtu dhe mbi pikën 3, të nenit 2 dhe të pikës 3, të nenit 3, të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Në këto pika është përcaktuar qartë se administrata shtetërore funksionon në mënyrë hierarkike, ku ndër të tjera një nga parimet kryesore është ai i llogaridhënies midis institucioneve në mënyrë hierarkike.

Ndryshimi i mësipërm është në linjë me pikën 1, të nenit 6 të këtij ligji i cili shprehimisht përcakton se Këshilli i Ministrave është institucioni i cili zhvillon dhe e zbaton politikën e kontrollit për transferimin ndërkombëtar. Për këtë arsye ndryshimi i bërë përfshin dhënien e disa kompetencave Këshillit të Ministrave, pasi ky institucion ka si kompetencë ligjbërjen, ndërsa AKSHE-ja është një institucion varësie ligjzbatues.

5. Të rishikohet zëvendësimi i fjalës “miraton” me fjalën “vendos”, në pikën 3, të nenit 14 pasi ky ndryshim e bën fjalinë të pakuptueshme.

- Sugjerimi nuk është pranuar, pasi AKSHE-ja, siç është shpjeguar dhe në relacionin e dërguar për mendim, ka kompetenca vendimmarrje. Fjala “miraton” është zëvendësuar me fjalën “vendos”, pasi ky institucion vendos vendime vetë përbrenda saj. Fjala “miraton” është hequr për shkak të paqartësisë juridike, pasi ky institucion nuk miraton vendimet e ndonjë institucioni tjetër, por është po ky institucion i cili vendos me procedurat e saj të brendshme mbi vendimet të cilat merren mbi subjektet.

6. Në kushtet kur pika 2, e nenit 21 nuk ka paragraf të dytë, togfjalëshi “paragrafi dytë” të zëvendësohet me togfjalëshin “fjalë e dytë”.

- Sugjerimi është pranuar dhe është reflektuar në përmbajtjen e projektligjit.

7. Sa i përket nenit 8 të projektligjit, siç është theksuar edhe më sipër, nuk është e qartë arsyeja pse kompetencat e AKSHE, i kalojnë Këshillit të Ministrave, pasi edhe në relacionin bashkëlidhur projektligjit nuk përmendet arsyeja apo dakordësimet që kanë bërë palët për të arritur në konkluzionin që këto kompetenca duhet t'i kalojnë Këshillit të Ministrave.

- Sugjerimi nuk është marrë parasysh, për këtë sugjerim është dhënë arsyetimi në komentin nr.4.

8. Ndryshimi i shkronjës “c”, në pikën 1 të nenit 29, nuk duhet të kryhet pasi kjo dispozitë nuk është në përputhje me Kodin e Procedurave e Administrative, si dhe çështjet që synohet të rregullohen prej saj, rregullohen nga Kodi i Procedurave Administrative, i cili është drejtpërdrejtë i zbatueshëm.

- Sugjerimi nuk është pranuar pasi ndryshimi i propozuar në projektligj është mbi riformulimin e gërmës “ç”, të pikës 1, të nenit 29 dhe jo të pikës “c”.

9. Sa i përket nenit 10 të projektligjit, në përputhje me paragrafët 200 dhe 340 të Manualit të Hartimit të Legjislacionit, miratuar me udhëzimin nr. 6 datë 29.04.2022 të Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”, pika 2 e nenit 30, të riformulohet duke parashikuar detyrimin për pezullimin e licencës dhe jo mundësinë e marrjes së vendimit për pezullimin e përkohshëm të licencës. Ky koment të mbahet në konsideratë edhe për ndryshimet që bëhen në dispozita të tjera të ngjashme të ligjit.

- Sugjerimi është pranuar dhe është reflektuar në përmbajtjen e projektligjit.

10. Ndryshimi që kryhet në shkronjat “d” dhe “dh”, të pikës 1, të nenit 38, si dhe shkronjën “k” të nenit 41, është i panevojshëm në kushtet kur ligji nuk parashikon lëshimin e licencës në format elektronik dhe si pasojë në çdo rast kur parashikohet kthimi i licencës do të kthehet origjinali i printuar. Sa i përket rregullimit të kësaj çështje për periudhën tranzitore nga hyrja në fuqi e ligjit dhe ofrimit të shërbimit online, ky projektligj duhet të parashikojë një dispozitë tranzitore e cila rregullon të gjitha çështjet që lidhen me aplikimin, ofrimin e shërbimit online dhe se si veprohet për kthimin e licencave të lëshuara.

- Sugjerimi është pranuar dhe është reflektuar në përmbajtjen e projektligjit, duke e shtuar si dispozitë kalimtare.

11. Neni 38 nuk përmban ndonjë detyrim për të raportuar dhe si pasojë është i paqartë togfjalëshi “formatet e raportimit” i parashikuar në pikën 2, që ndryshohet në nenin 38. Nga ana tjetër, në relacionin shpjegues mungojnë argumentet se pse formatet e raportimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe jo me urdhër të organit drejtues të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, siç është parashikuar në ligjin në fuqi.

- Sa i përket fjalisë së parë në sugjerimin e mësipërm, togfjalëshi nuk është objekt i ndryshimeve të këtij projektligji. Arsyet janë po të njëjtat të shpjeguara në komentin nr.4 dhe nr.7.

12. Për shkronjat “b” deri te “d” të cilat ndryshohen në pikën 1, të nenit 41, tipologjia e sanksionit është ndryshuar, nga gjoha e përcaktuar në kufi minimalë dhe maksimalë, në gjobë me një shumë fikse, e cila përkon me kufirin minimal të dispozitave në fuqi, por mungojnë argumentet në relacionin shoqërues në lidhje me këtë ndryshim, si dhe nëse këto gjoha janë

proporcionale në raport me shkeljet, pasojat që sjellin shkeljet, si dhe efektin parandalues të tyre.

Nga ana tjetër, në lidhje me këto parashikime duhet të mbahen në konsideratë edhe nenet 10 dhe 18 të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. Sillet në vëmendje se rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes, dënimi i mëparshëm i kundërvajtësit, rëndësia e kundërvajtjes dhe pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi, apo rrethana të tjera shtesë si bashkëpunimi i kundërvajtësit gjatë procedurës së konstatimit të kundërvajtjes administrative, qëndrimi i tij ndaj shkeljes së konstatuar, masat e marra për shmangien e shkeljes ose pasojave të ardhura prej saj, janë të gjithë faktorë të cilët sjellin si pasojë nevojën për të identifikuar një masë proporcionale të sanksionit administrativ, e cila jo domosdoshmërisht është e njëjtë për çdo shkelje dhe çdo kundërvajtës.

- Sugjerimi është pranuar dhe ky ndryshim është hequr nga përmbajtja e projektligjit.

14. Sa i përket paragrafit të dytë të nenit 14 të projektligjit, vlerësojmë se ajo duhet të riformulohet në tërësi, pasi fjala “mund”, i lë një diskrecion të gjerë organit publik, pa përcaktuar kushtet, kriteret dhe rastet kur organi mund të vendosë sanksione shtesë kundrejt subjektit.

- Sugjerimi është pranuar dhe është reflektuar në përmbajtjen e projektligjit duke hequr fjalën “mund”.

15. Në pikën 5, të nenit 44 duhet të shfuqizohet vetëm togfjalëshi “në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin për inspektimin”. Sillet në vëmendje se për një veprim administrativ mund të bëhet vetëm një herë ankim administrativ. Në rastin konkret, ndaj vendimit të zyrtarit autorizues mund të paraqitet ankim te komisioni i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni dhe ndaj vendimit të komisioni mund të paraqitet ankim vetëm në gjykatën kompetente, pasi tashmë është ezauruar ankimi administrativ ndaj aktit administrativ.

- Sugjerimi është pranuar dhe është reflektuar në përmbajtjen e projektligjit.

16. Projektligji të ripunohet në tërësi në përputhje me parashikimet e udhëzimit nr. 6 datë 29.04.2022 të Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”, si dhe Manualit për Hartimin e Legjislacionit bashkëlidhur tij.

- Sugjerimi është pranuar dhe është reflektuar në përmbajtjen e projektligjit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte apo kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

MINISTRI

Niko Peleshi